

KOLEGJI "BIZNESI"

Nr. 462/20 Data: 02.12.20
PRIZREN



KOLEGJI - COLLEGE
BIZNESI
Prishtinë



MEMORANDUMI BASHKËPUNIMI

Neni 1

Palët nënshkruese të këtij memorandumi:

1. Kolegji BIZNESI-Prishtinë, rruga "Motrat Qiriazhi" nr 29 të cilën e përfaqëson Dr. Shyqeri Kabashi -Dekan, dhe
2. KAG - Asphalt Company SH.P.K., Adresa: Krushë e Vogël p.n. Prizren R. e Kosovës, me NRB 810593518.

Neni 2

Qëllimi i këtij Memorandumi

Ky Memorandum bashkëpunimi ka për qëllim përcaktimin e fushave të bashkëpunimit, kushteve dhe afatet themelore, në bazë të të cilave Kolegji BIZNESI- Prishtinë dhe KAG - Asphalt Company SH.P.K. - Prizren, pajtohen për bashkëpunim.

Neni 3

Fushat e bashkëpunimit

1. KAG - Asphalt Company SH.P.K. - Prizren do të ndihmojë dhe mbështesë në vazhdimësi Kolegjin Biznesi, në pranimin e studentëve për realizimin e praktikës, dhe dhënjën e sygjërimeve për nevojat e ekonomisë së tregut si pal e interesit nga jashtë, të bazuar në politikat e këtij institucionit.
2. Kolegji Biznesi do të mbështesë në vazhdimësi KAG - Asphalt Company SH.P.K. - Prizren në aspektin e trajnimeve në fushat: **Menaxhimi i emergjencave** (mbrojtjes nga zjarrit duke kontrolluar dhe servisuar aparaturat për shuarjen e zjarrit), **Ekonomisë** (hartimin e pasqyrave financiare dhe planit të biznesit), **Juridike** (hartimi i kontratave dhe rregulloreve) dhe ngritjen e kapaciteteve profesionale të personelit.
3. Kolegji Biznesi do të mbështesë, KAG - Asphalt Company SH.P.K. - Prizren me stafin e sajë akademik, për ligjërata nga lëmia: Emergjencave, Ekonomisë dhe Jurispodencës-sipas nevojave që paraqet. KAG - Asphalt Company SH.P.K.



Neni 4
Interpretimi dhe ndryshimi i memorandumit

1. Interpretimi i këtij Memorandumi do të bëhet në pajtim me Ligjet e Kosovës, duke e ruajtur parimin e reciprocitetit.
2. Afati i këti memorandumit është në kohë të pacaktuar. Ndryshimet dhe plotësimet e këti Memorandumi mund të bëhen vetëm me shkrim dhe të nënshkruara nga të dyja palët.

Neni 5
Kopjet e Memorandumit


Memorandumi është punuar në katër kopje origjinale, nga dy kopje për secilën palë.

Neni 6
Hyrja në fuqi

Ky Memorandum hynë në fuqi ditën e nënshkrimit nga palët.


PALËT NËNSHKRUESE

Kolegji BIZNESI Prishtinë


/Prof. Dr. Shyqer Kabashi/
D e k a n



KAG - Asphalt Company SH.P.K.


/Esad Gashi /
Drejtore



Nënshkruar në Prishtinë, me datë 08/12 /2020

